

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

Heqja dorë / ez-Zuhd / الزهد

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës
<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ thotë:

“Ajo çfarë mbetet (hallall) nga Allahu, është më e mira për ju ...” (Hûd, 86)¹

Zuhdi i referohet të hequrit dorë të plotë nga diçka. Kjo heqje dorë është një akt i virtytshëm për sa i përket shumicës së besimtarëve, është një domosdoshmëri² për sa i përket elitës së besimtarëve, dhe është një strehim³ për sa i përket ajkës së elitës së besimtarëve. Heqja dorë ka tri nivele:

Niveli i parë – Heqja dorë nga të gjithë gjërat e dyshimta pasi të heqësh dorë plotësisht nga gjërat e paligjshme (haram). Dhe kjo ka tri nivele:

- Frika nga fajësimi⁴
- Shmangia e hirshme nga mangësitë⁵
- Urrejtja ndaj shoqërimit me të ligët⁶

¹ Ajo çfarë ti fiton, pasi të heqësh dorë nga mashtrimi dhe nga të gjitha format e sjelljes së keqe në biznes, është më e bereqetshme dhe më e mirë për ty.

² Ky është një parakusht i shtegut të pastrimit shpirtëror.

³ Ky strehim është për ata që i druajnë humbjes së pozitës së tyre tek Allahu, nëse i rreken përmbushjes së dëshirave. Këta mbahen fort për stacionin e heqjes dorë nga frika se mos dynjaja po i shpërqendron.

⁴ Gjërat e dyshimta nuk janë haram në vetvete, kështu që nuk nënkuptojnë mëkatim medoemos. Mirëpo, kjo kategori njerëzish druhen se do t'i fajësojë Allahu në Ditën e Gjykimit, nëse i afrohen haramit.

⁵ Ata që i konsiderojnë vetët e tyre si të atillë që u ruhen lëshimeve, i përmbahen një standardi më të lartë gjatë gjithë kohës.

⁶ Ti braktis vendet ku ata tubohen dhe i shmangesh garës me ta në dëshirat e ulëta që ata kultivojnë.

Niveli i dytë – Heqja dorë nga teprica dhe nga çfarëdo përtej furnizimit të domosdoshëm:

- Duke bërë investimin më të mirë në kohë⁷
- Duke ndalur ankthin⁸
- Duke zbukuruar veten me cilësitë e mira të pejgamberëve dhe të vërtetëve (*siddikëve*).

Niveli i tretë – Heqja dorë nga heqja dorë nëpërmjet plotësimit të tri gjërave:

- Duke nënvleftësuar atë nga çfarë ti heq dorë⁹
- Duke u treguar tërësisht indiferent ndaj rrethanave të ndryshme¹⁰
- Duke u përmbajtur nga të parët e veprimeve tua dhe duke hedhur shikimin nga lugina e të vërtetave¹¹

⁷ Duke mbjell farat për korrijen përfundimtare dhe duke iu afruar më shumë më të Dashurit (i lartësuar qoftë Ai!)

⁸ Në mënyrën që qetëson zemrën dhe nuk lë trazime, keqardhje, mëdyshje apo ngurrime të shkaktuara nga lidhjet e mbetura me dynjanë.

⁹ Asnjë gjë s'është tepër e madhe për të mos e lënë për Allahun. Në krahasim me kënaqësinë e Tij, të gjitha gjërat janë të parëndësishme.

¹⁰ Atëherë kur pasuria dhe varfëria, shëndeti dhe sëmundja, vëmendja e të tjerëve ndaj teje dhe braktisja që ta bëjnë ata, dhe të gjitha variacionet e tjera të bëhen të barabarta për ty; apo kur këto së paku të të mos shpërqendrojnë nga shërbimi (adhurimi) ndaj Tij, të të mos shkaktojnë gëzim apo vuajtje të mëdha, të të mos shkaktojnë mburrje apo pakënaqësi ndaj caktimeve të Tij, të të mos pengojnë nga të besuarit në atë që është e vërtetë, nga të vepruarit sipas saj dhe nga të folurit e saj.

¹¹ Kështu, ti nuk sheh (nuk vëren) heqjen dorë që ti bën. Madje, ti nuk sheh as aftësinë tënde për të hequr dorë nga diçka, meqë ti sheh vetëm veprimet dhe caktimet e Tij. Shikimi yt është i përqendruar në të vërtetat përfundimtare, pra në të quenët e Tij shkaktari i vërtetë, i Vetmi, e Vërteta vetë.